



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 205

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E enjte, 5 dhjetor 2024**

## PËRMBAJTJA

|                                                                                    | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ligj nr. 111/2024,<br>datë 31.10.2024                                              | Për disa ndryshime në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, i ndryshuar..... 22155                                                                                                                                                                                           |
| Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 582, datë 26.11.2024                 | Për njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit..... 22155 |
| Urdhër i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 1046, datë 2.12.2024 | Për ripërtëritjen e licencës së shoqatës “Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve Interpretues dhe Ekzekutues (A.K.D.I.E.)” si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues..... 22159                            |
| Urdhër i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 1047, datë 2.12.2024 | Për ripërtëritjen e licencës së shoqatës “Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve (ALBAUTOR)” si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të autorit për veprat letrare, artistike dhe shkencore..... 22159                                             |
| Urdhër i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 1048, datë 2.12.2024 | Për ripërtëritjen e licencës si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogramit, shoqatën “Faber Collective Phonogram”..... 22160                                                                                                                       |
| Urdhër i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 1049, datë 2.12.2024 | Për licencimin e “Shoqatës së Filmit Audiovizual, Artistik dhe Dokumentar (F.A.A.D)” si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të autorëve dhe producentëve të veprave audiovizuale..... 22160                                                                             |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1018, datë 26.11.2024     | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë..... 22161                                                                                                                                               |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1019, datë 26.11.2024     | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës..... 22162                                                                                                                                                                           |

|                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |       |
|--------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1020, datë 26.11.2024 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 22165 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1021, datë 26.11.2024 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Austrisë.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 22165 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1022, datë 26.11.2024 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë..                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 22166 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1023, datë 26.11.2024 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Austrisë.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 22167 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1024, datë 26.11.2024 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Holandës.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 22169 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1025, datë 26.11.2024 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Bullgarisë.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 22169 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1026, datë 26.11.2024 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Francës.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | 22170 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1027, datë 26.11.2024 | Për shfuqizimin e urdhrit nr. 716, datë 18.9.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Danimarkës”, urdhrit nr. 787, datë 4.10.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Moldavisë” dhe urdhrit nr. 156, datë 4.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Norvegjisë” ..... | 22171 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1028, datë 26.11.2024 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Italisë.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | 22171 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1029, datë 26.11.2024 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 22172 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1030, datë 26.11.2024 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 22173 |

|                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                             |       |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1031, datë 26.11.2024                                                     | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Republikës së Çekisë.....                                        | 22175 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1032, datë 26.11.2024                                                     | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë.....                                                                                  | 22175 |
| Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 2176, datë 26.11.2024                                  | Për delegim kompetence.....                                                                                                                                                                 | 22177 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 43, datë 8.11.2024 | Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Vlorë sh.a.....                                                                                                                  | 22178 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 46, datë 2.12.2024 | Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a.....                               | 22179 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 47, datë 2.12.2024 | Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a.....                           | 22184 |
| Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 1168/9, datë 2.12.2024                                                         | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim muri rrethues për godinën e re të SPAK-ut” ..... | 22190 |



**LIGJ**  
**Nr. 111/2024****PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN**  
**NR. 9693, DATË 19.3.2007, “PËR FONDIN**  
**KULLOSOR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

**Neni 1**

Në nenin 10 pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Në rastet kur në fondin kullor publik dhe privat janë miratuar vendimmarrje të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për zhvillime turistike, nuk ndiqet procedura e heqjes nga fondi kullor, por struktura e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave bashkiake, pasi merr dijeni, bën azhurnimin kadastral në kadastrën e fondit kullor dhe e raporton atë në sistemin ALFIS.”.

**Neni 2**

Në nenin 17 pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Sipërfaqe të caktuara dhe toka të fondit kullor mund të jepen në përdorim për të zhvilluar në to veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme mbështetur në kërkesat si më poshtë:

a) për lejimin e veprimtarive shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike kërkohet që këto veprimtari:

i. të jenë të parashikuara në planin e mbarështimit të kullotës apo livadhit, ose kur nuk bie në kundërshtim me synimet e kërkesat e këtij plani;

ii. të mos dëmtojnë mjedisin rrethues dhe të mos sjellin pasojë të vazhdueshme negative mbi të;

iii. subjekti zhvillues të realizojë në vijimësi dhe përfundimisht rehabilitimin e sipërfaqes së marrë në

përdorim, në përputhje me planin e rehabilitimit të hartuar prej tij e të miratuar nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki.

b) për lejimin e ushtrimit të veprimtarive që lidhen me prodhimin e energjisë së rinovueshme në fondin kullor shtetëror ngarkohen njësitë e qeverisjes vendore për ndjekjen e procedurave ligjore përkatëse për dhënien e së drejtës së përdorimit.”.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 31.10.2024.

**URDHËR**  
**Nr. 582, datë 26.11.2024****PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË**  
**PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË**  
**ANËTARIT TË BORDIT TË**  
**ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES I**  
**MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR**  
**ARSIMIN, NË UNIVERSITETIN E**  
**ELBASANIT “ALEKSANDËR**  
**XHUVANI”, MËNYRËN E VLERËSIMIT**  
**TË KANDIDATËVE DHE AFATIN E**  
**DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 7, të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

**URDHËROJ:**

1. Njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në



Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përzgjedhja e kandidatit për anëtar të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit, do të jetë deri në datën 10.12.2024.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedurave që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin e anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al).

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Ogerta Manastirliu**

SHTOJCA NR. 1

NJOFTIM  
PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARIT TË  
BORDIT TË ADMINISTRIMIT,  
PËRFAQËSUES I MINISTRISË  
PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË  
UNIVERSITETIN E ELBASANIT  
“ALEKSANDËR XHUVANI”

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe të urdhrit nr. 582, datë 26.11.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’, mënyrën e

vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, si më poshtë:

| Nr. | Institucioni publik i arsimit të lartë        | Numri i anëtarëve për Bord Administrimi |
|-----|-----------------------------------------------|-----------------------------------------|
| 1   | Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” | - 1 anëtar përfaqësues i MAS-it         |

### 1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike, dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

### 2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;



- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njërive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

- është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;

- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektori.

### 3. Kërkesat e pranimit

#### a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë shtetas shqiptar;

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;

- të ketë integritet etik dhe profesional;

- të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

- të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

- të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

#### b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;

- të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e

integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;

- të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

- të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi;

- të njohë të paktën një gjuhë të huaj;

- të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;

- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

### 4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë për aplikim;

- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (*CV-curriculum vitae*);

- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet vërtetimi i njohjes dhe njehsimit të diplomës/certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;

- Fotokopje të librezës së punës;

- Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;

- Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;

- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;

- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;

- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;

- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.



**5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 10.12.2024, në një nga këto mënyra:**

a) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila e vë në dispozicion të Komisionit “*ad hoc*” të ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

**6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur**

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit të administrimit kryhet nga një komision “*ad-hoc*” i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin,

i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatin e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al).

**7. Masa e shpërblimit**

Bazuar në VKM-në nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

SHTOJCA NR. 1/1

**VETËDEKLARIM MBI MOSANGAZHIMIN NË FUNKSIONE DREJTUESE PARTIAKE**

Deklaruesi: \_\_\_\_\_

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se \_\_\_\_\_ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

SHTOJCA NR. 1/2

**VETËDEKLARIM MBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

Deklaruesi: \_\_\_\_\_

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se \_\_\_\_\_ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_



SHTOJCA NR. 1/3

**VETËDEKLARIM PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË  
PARAQITURA NGA KANDIDATI**

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionin publik të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

**URDHËR****Nr. 1046, datë 2.12.2024****PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË  
SHOQATËS “AGJENCIA E  
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË  
DREJTAVE TË ARTISTËVE  
INTERPRETUES DHE EKZEKUTUES  
(A.K.D.I.E.)” SI AGJENCI E  
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NË  
FUSHËN E TË DREJTAVE TË  
ARTISTËVE INTERPRETUES DHE  
EKZEKUTUES**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar; të vendimit nr. 33, datë 1.1.2017, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e së Drejtës së Autorit”, si dhe të udhëzimit nr. 338, datë 2.6.2023, të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kritereve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës”,

**URDHËROJ:**

1. Ripërtëritjen e licencës për subjektin A.K.D.I.E., shoqatë e regjistruar me vendimin nr. 2224, datë 4.4.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIP: K82311451P, si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve.

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS  
DHE INOVACIONIT  
**Blendi Gonxhja**

**URDHËR****Nr. 1047, datë 2.12.2024****PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË  
SHOQATËS “AGJENCIA E  
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË  
DREJTAVE TË AUTORËVE  
(ALBAUTOR)” SI AGJENCI E  
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NË  
FUSHËN E TË DREJTAVE TË AUTORIT  
PËR VEPRAT LETRARE, ARTISTIKE  
DHE SHKENCORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, vendimit nr. 33, datë 1.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e së Drejtës së Autorit”, si dhe udhëzimit nr. 338, datë 2.6.2023, të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit, “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kritereve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës”,



## URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës për subjektin ALBAUTOR, shoqatë e regjistruar me vendimin nr. 578, datë 18.2.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT: J81512003D, si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit në çdo krijim intelektual original në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës, përveçse administrimin kolektiv të të drejtave të autorit të krijimeve audiovizuale, në të cilat përfshihen edhe krijimet kinematografike.

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS  
DHE INOVACIONIT  
Blendi Gonxhja

## URDHËR

Nr. 1048, datë 2.12.2024

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SI  
AGJENCI E ADMINISTRIMIT  
KOLEKTIV NË FUSHËN E TË  
DREJTAVE TË PRODHUESVE TË  
FONOGRAMIT, SHOQATËN “FABER  
COLLECTIVE PHONOGRAM”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, vendimit nr. 33, datë 1.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e së Drejtës së Autorit”, si dhe udhëzimit nr. 338, datë 2.6.2023, të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës”,

## URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës për subjektin “Faber Collective Phonogram”, shoqatë e regjistruar me vendimin nr. 6612, datë 21.1.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT: M11327456H, si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit në kategorinë e të drejtave të prodhuesve të fonogramit.

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS  
DHE INOVACIONIT  
Blendi Gonxhja

## URDHËR

Nr. 1049, datë 2.12.2024

**PËR LICENCIMIN E “SHOQATËS SË  
FILMIT AUDIOVIZUAL, ARTISTIK DHE  
DOKUMENTAR (F.A.A.D)” SI AGJENCI  
E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NË  
FUSHËN E TË DREJTAVE TË  
AUTORËVE DHE PRODUCENTËVE TË  
VEPRAVE AUDIOVIZUALE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, vendimit nr. 33, datë 1.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e së Drejtës së Autorit”, si dhe udhëzimit nr. 338, datë 2.6.2023, të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës”,

## URDHËROJ:

1. Licencimin e subjektit F.A.A.D, shoqatë e regjistruar me vendimin nr. 7388, datë 10.9.2024, të



Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me NIPT: M42116451I, si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorëve dhe producentëve të veprave audiovizuale.

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet F.A.A.D për njoftimin e Sportelit Unik lidhur me anëtarësimin në Bordin e Drejtorëve.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS  
DHE INOVACIONIT  
Blendi Gonxhja

**URDHËR**  
**Nr. 1018, datë 26.11.2024**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE  
ME PATOGJENITET TË LARTË TË  
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E HUNGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Hungarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

| Ndarja administrative e nivelit 1 | * Ndarja administrative e nivelit 2 |
|-----------------------------------|-------------------------------------|
| Nógrád                            | Salgótarján*                        |
| Békés                             | Sarkad*                             |
| Szabolcs-Szatmár-Bereg            | Tiszavasvári*                       |
| Szabolcs-Szatmár-Bereg            | Nyírbátor*                          |
| Szabolcs-Szatmár-Bereg            | Mátészalka*                         |
| Jász-Nagykún-Szolnok              | Tiszafüred*                         |
| Komárom-Esztergom                 | Komárom*                            |
| Békés                             | Szeghalom*                          |
| Békés                             | Szarvas*                            |
| Hajdú-Bihar                       | Hajdúböszörmény*                    |
| Bács-Kiskun                       | Kiskunfélegyháza*                   |
| Bács-Kiskun                       | Kiskunmajsa*                        |
| Bács-Kiskun                       | Baja*                               |
| Hajdú-Bihar                       | Hajdúhadház*                        |
| Hajdú-Bihar                       | Berettyóújfalú*                     |
| Békés                             | Orosháza*                           |
| Bács-Kiskun                       | Jánoshalma*                         |
| Hajdú-Bihar                       | Polgár*                             |
| Bács-Kiskun                       | Kiskunhalas*                        |
| Baranya                           | Komló*                              |
| Komárom-Esztergom                 | Kisbér*                             |
| Jász-Nagykún-Szolnok              | Szolnok*                            |
| Somogy                            | Kadarkút*                           |
| Bács-Kiskun                       | Kecskemét*                          |
| Hajdú-Bihar                       | Létavértes*                         |
| Csongrád-Csanád                   | Kistelek*                           |
| Bács-Kiskun                       | Kiskőrös*                           |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 990, datë 20.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe



Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
Anila Denaj

URDHËR  
Nr. 1019, datë 26.11.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE  
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E UKRAINËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të  $F_0$  prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

| Ndarja administrative e nivelit të parë | Ndarja administrative e nivelit të dytë | Ndarja administrative e nivelit të tretë |
|-----------------------------------------|-----------------------------------------|------------------------------------------|
| Chernihiv                               | Ripkyns'kyi*                            |                                          |
| Chernihiv                               | Chernivets'ka*                          |                                          |
| Chernihiv                               | Nizhyns'kyi*                            |                                          |
| Chernihiv                               | Kozelets'kyi*                           |                                          |
| Chernihiv                               | Pryluts'kyi*                            |                                          |
| Chernihiv                               | Nosivs'kyi*                             |                                          |
| Chernihiv                               | Stribnians'kyi*                         |                                          |
| Chernihiv                               | Mens'kyi*                               |                                          |
| Chernivtsi                              | Hlybots'kyi*                            |                                          |
| Chernivtsi                              | Zastavnets'kyi*                         |                                          |
| Cherkasy                                | Smilians'kyi*                           |                                          |
| Cherkasy                                | Cherkas'kyi*                            |                                          |
| Donets'k                                | Slovians'kyi*                           |                                          |

|                  |                            |  |
|------------------|----------------------------|--|
| Donets'k         | Krasnolymans'kyi*          |  |
| Kharkiv          | Krasnokuts'kyi*            |  |
| Kharkiv          | Novovodolaz'kyi*           |  |
| Kharkiv          | Valkivs'kyi*               |  |
| Kiev             | Obukhivs'kyi*              |  |
| Kiev             | Vyshhorods'kyi*            |  |
| Kiev             | Boryspil's'ka*             |  |
| Kiev             | Ivankivs'kyi*              |  |
| Kiev             | Holosiv's'kyi*             |  |
| Kiev             | Rokytnians'kyi*            |  |
| Kiev             | Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi* |  |
| Kiev             | Bilotserkivs'kyi*          |  |
| Kiev             | Baryshivs'kyi*             |  |
| Kiev             | Kaharlyts'kyi*             |  |
| Kiev             | Iahotyns'kyi*              |  |
| Kiev             | Tarashchans'kyi*           |  |
| Kiev             | Myronivs'kyi*              |  |
| Kirovohrad       | Dobrovelychkivs'kyi*       |  |
| Kirovohrad       | Kirovohrads'kyi*           |  |
| Kirovohrad       | Novomyrhorods'kyi*         |  |
| Kirovohrad       | Novoukrains'kyi*           |  |
| Kirovohrad       | Oleksandriis'kyi*          |  |
| Kirovohrad       | Petrivs'kyi*               |  |
| Kirovohrad       | Svitlovods'kyi*            |  |
| Kirovohrad       | Znamians'kyi*              |  |
| Zhytomyr         | Zhytomyrs'ka*              |  |
| Zhytomyr         | Berdychivs'kyi*            |  |
| Volyn            | Volodymyr-Volyns'kyi*      |  |
| Kherson          | Beryslavs'kyi*             |  |
| Kherson          | Novovorontsovs'kyi*        |  |
| Mykolayiv        | Mykolaivs'kyi*             |  |
| Mykolayiv        | Berezans'kyi*              |  |
| Mykolayiv        | Berezhnivats'kyi*          |  |
| Mykolayiv        | Kazanetskyi*               |  |
| Mykolayiv        | Kryvoozers'kyi*            |  |
| Mykolayiv        | Vradivs'kyi*               |  |
| Odessa           | Kotovs'kyi*                |  |
| <b>Odessa</b>    | <b>Izmad's'ka*</b>         |  |
| Odessa           | Billhorod-Dnistrovs'kyi*   |  |
| Odessa           | Biliav's'kyi*              |  |
| Poltava          | Hlobyns'kyi*               |  |
| Poltava          | Kobelians'kyi*             |  |
| Poltava          | Kozel'shchyns'kyi*         |  |
| Poltava          | Poltavs'kyi*               |  |
| Poltava          | Semenivs'kyi*              |  |
| Ivano-Frankivs'k | Kolomyis'kyi*              |  |
| Sumy             | Konotops'kyi*              |  |
| Sumy             | Lebedyns'kyi*              |  |
| Sumy             | Romens'kyi*                |  |
| Vinnitsya        | Iampil's'kyi*              |  |
| Vinnitsya        | Illinets'kyi*              |  |
| Vinnitsya        | Lypovets'kyi*              |  |
| Zaporizhzhya     | Orikhivs'kyi*              |  |

Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.



2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të  $F_0$  prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të

Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit;

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**



a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të

Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 932, datë 6.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të Derrave të shfaqur në shtetin Ukrainës”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Anila Denaj**



## URDHËR

Nr. 1020, datë 26.11.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE  
ME PATOGJENITET TË LARTË TË  
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E GJERMANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, neni 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Gjermanisë, sipas tabelës së mëposhtme:

| *Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | Ndarja administrative e nivelit 3 |
|------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| Nordrhein                          | Kleve                             | Kleve*                            |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinarë të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së

Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

## URDHËR

Nr. 1021, datë 26.11.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE  
ME PATOGJENITET TË LARTË TË  
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E AUSTRIËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, neni 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Austrisë, sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | *Ndarja administrative e nivelit 3 |
|-----|-----------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| 1   | Oberösterreich                    | Braunau am Inn                    | Mattighofen*                       |
| 2   | Niederösterreich                  | Amstetten                         | Kematen an der Ybbs*               |
| 3   | Niederösterreich                  | Amstetten                         | Biberbach*                         |
| 4   | Niederösterreich                  | Amstetten                         | Emsthofen*                         |
| 5   | Niederösterreich                  | Amstetten                         | Aschbach-Markt*                    |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinarë të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.



3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 992, datë 20.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Austrisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
Anila Denaj

URDHËR  
Nr. 1022, datë 26.11.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE  
ME PATOGJENITET TË LARTË TË  
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;

Faqe | 22166

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;  
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht,

nga shteti i Bullgarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

| Ndarja administrative e nivelit 1 | *Ndarja administrative e nivelit 2 |
|-----------------------------------|------------------------------------|
| Plovdiv                           | Maritsa*                           |
| Plovdiv                           | Plovdiv*                           |
| Yambol                            | Tundzha*                           |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 903, datë 4.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
Anila Denaj



## URDHËR

Nr. 1023, datë 26.11.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË  
SHFAQUR NË SHTETIN E AUSTRIËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve,

nga shteti i Austrisë, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

| Ndarja administrative e nivelit të parë | Ndarja administrative e nivelit të dytë* | Ndarja administrative e nivelit të tretë |
|-----------------------------------------|------------------------------------------|------------------------------------------|
| Niederösterreich                        | Bruck an der Leitha                      | Mannersdorf am Leithagebirge*            |
| Kärnten                                 | Feldkirchen                              | Ossiach*                                 |
| <b>Kärnten</b>                          | <b>Feldkirchen</b>                       | <b>St. Urban*</b>                        |
| Kärnten                                 | Spittal an der Drau                      | Kleblach-Lind*                           |
| Kärnten                                 | Klagenfurt-Land                          | Ebenthal in Kärnten*                     |
| Kärnten                                 | Wolfsberg                                | St. Andrä*                               |
| Kärnten                                 | Wolfsberg                                | Lavamünd*                                |
| Tirol                                   | Kufstein                                 | Radfeld*                                 |
| Tirol                                   | Kufstein                                 | Niederdorferberg*                        |
| Tirol                                   | Kufstein                                 | Walchsee*                                |
| Tirol                                   | Schwaz                                   | Bruck am Ziller*                         |
| Tirol                                   | Schwaz                                   | Hart im Zillertal*                       |
| Tirol                                   | Schwaz                                   | Schwaz*                                  |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Alberschwende*                           |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Andelsbuch*                              |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Bezaun*                                  |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Eichenberg*                              |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Egg*                                     |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Mellau*                                  |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Mögggers*                                |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Hard*                                    |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Hittisau*                                |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Höchst*                                  |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Hohenweiler*                             |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Hörbranz*                                |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Langeneck*                               |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Langen bei Bregenz*                      |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Lauterach*                               |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Lingenau*                                |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Lochau*                                  |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Sulzberg*                                |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Riefensberg*                             |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Wolfurt*                                 |
| Vorarlberg                              | Bregenz                                  | Bürserberg*                              |
| Vorarlberg                              | Bludenz                                  | Ludesch*                                 |
| Vorarlberg                              | Bludenz                                  | Nenzing*                                 |

|                   |                               |                                           |
|-------------------|-------------------------------|-------------------------------------------|
| Vorarlberg        | Bludenz                       | St. Gerold*                               |
| Vorarlberg        | Dornbirn                      | Reuthe*                                   |
| Vorarlberg        | Dornbirn                      | Hohenems*                                 |
| Vorarlberg        | Dornbirn                      | Dornbirn*                                 |
| Vorarlberg        | Dornbirn                      | Lustenau*                                 |
| Vorarlberg        | Feldkirch                     | Fraxern*                                  |
| Vorarlberg        | Feldkirch                     | Koblach*                                  |
| Vorarlberg        | Feldkirch                     | Rankweil*                                 |
| Vorarlberg        | Feldkirch                     | Viktorsberg*                              |
| Vorarlberg        | Feldkirch                     | Zwischenwasser*                           |
| <b>Salzburg</b>   | <b>Sankt Johann im Pongau</b> | <b>Altenmarkt im Pongau*</b>              |
| Steiermark        | Graz Umgebung                 | Nestelbach bei Graz*                      |
| Steiermark        | Murau                         | Scheifling*                               |
| <b>Steiermark</b> | <b>Murau</b>                  | <b>Sankt Margarethen bei Knittelfeld*</b> |
| Steiermark        | Murtal                        | Lobmingtal*                               |
| Steiermark        | Leibnitz                      | Großklein*                                |
| Steiermark        | Leibnitz                      | Kitzeck im Sausal*                        |
| Steiermark        | Leoben                        | Traboch*                                  |
| Steiermark        | Voitsberg                     | Geistthal-Södingberg*                     |
| Steiermark        | Voitsberg                     | Mooskirchen*                              |
| Steiermark        | Voitsberg                     | Stallhofen*                               |
| Steiermark        | Weiz                          | Passail*                                  |
| Steiermark        | Weiz                          | St. Margarethen an der Raab*              |
| <b>Tirol</b>      | <b>Kitzbühel</b>              | <b>Hopfgarten im Brixental*</b>           |
| Tirol             | Kufstein                      | Rettenschöss*                             |
| Vorarlberg        | Bregenz                       | Schwarzenberg*                            |
| Vorarlberg        | Bregenz                       | Doren*                                    |
| Steiermark        | Voitsberg                     | Sankt Martin am Wöllmißberg*              |
| Steiermark        | Voitsberg                     | Voitsberg*                                |
| Steiermark        | Voitsberg                     | Bärnbach*                                 |

Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera



të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitropa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitropave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

d) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitropat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 994, datë 20.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Austrisë”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël dhe spermën, dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Anila Denaj**



## URDHËR

Nr. 1024, datë 26.11.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE  
ME PATOGJENITET TË LARTË TË  
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E HOLANDËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, e tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Holandës, sipas tabelës së mëposhtme:

| *Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | Ndarja administrative e nivelit 3 |
|------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| Gelderland                         | Putten*                           |                                   |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave

Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Anila Denaj**

## URDHËR

Nr. 1025, datë 26.11.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË PESTËS SË  
RUMINANTËVE TË VEGJËL TË  
SHFAQUR NË SHTETIN E  
BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, e tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Bullgarisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë të vegjël dhe ruminantë të vegjël të egër;

b) materialit biologjik dhe embrioneve të pashoqëruara me test diagnostik PCR të rezultuar negativ, bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;

c) mishit dhe produkteve të mishit të patrajtuar termikisht minimalisht me një temperaturë 70°C për të paktën 30 minuta;

d) qumështit dhe produkteve të qumështit të patrajtuara termikisht minimalisht me një temperaturë 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë me pasterizim me kohë të shkurtër HTST) e paaplikuar 2 herë;

e) miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjam, thundra, kthetra dhe brirë të patrajtuara termikisht minimalisht me një temperaturë 70°C për të paktën 30 minuta;

f) leshin, flokët të cilët nuk kanë pësuar trajtimet e mëposhtme:



i. larje industriale, e cila konsiston në zhytjen e leshit në një sërë banjash me ujë, sapun dhe hidroksid natriumi (sode) ose hidroksid kaliumi (potasium);

ii. depilimi kimik me anë të gëlqeres së shuar ose sulfurit të natriumit;

iii. tymosje me formaldehyd në një dhomë të mbyllur hermetikisht për të paktën 24 orë;

iv. pastrim industrial, i cili konsiston në zhytjen e leshit në një detergjent të tretshëm në ujë të mbajtur në 60–70°C;

v. ruajtja e leshit në 4°C për katër muaj, 18°C për katër javë ose 37°C për tetë ditë.

g) lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël të patrajtuar për të paktën 28 ditë me kripë (NaCl) që përmban 2% karbonat natriumi (Na<sub>2</sub>CO<sub>3</sub>);

h) trofetë e gjetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël të papërpunuara, të pathara plotësisht dhe që kanë gjurmë të lëkurëve, mishit ose tendinave ose janë të padezinfektuar në mënyrë adekuate;

i) produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël, që nuk janë përpunuar për të siguruar shkatërrimin e virusit të pestës së ruminantëve të vegjël.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë të vegjël, ruminantë të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe produkteve të mishit, qumështit dhe produkteve të qumështit, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjam, thundra, kthetra dhe brirë, leshin, flokët, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël, trofetë e gjetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël, produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Anila Denaj**

**URDHËR**  
**Nr. 1026, datë 26.11.2024**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE  
ME PATOGJENITET TË LARTË TË  
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E FRANCËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, e tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Francës, sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | *Ndarja administrative e nivelit 3 |
|-----|-----------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| 1.  | Bretagne                          | Morbihan                          | Vannes*                            |
| 2.  | Bretagne                          | Morbihan                          | Pontivy*                           |
| 3.  | Nouvelle-Aquitaine                | Landes                            | Dax*                               |
| 4.  | Auvergne-Rhône-Alpes              | Allier                            | Moulins*                           |
| 5.  | Bretagne                          | Finistère                         | Morlaix*                           |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin



Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 988, datë 20.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Anila Denaj**

#### URDHËR

Nr. 1027, datë 26.11.2024

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 716, DATË 18.9.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E DANIMARKËS”, URDHRIT NR. 787, DATË 4.10.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E MOLDAVISË” DHE URDHRIT NR. 156, DATË 4.3.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E NORVEGJISË”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për

shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 3, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

#### URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 716, datë 18.9.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Danimarkës”, urdhrin nr. 787, datë 4.10.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Moldavisë” dhe urdhrin nr. 156, datë 4.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Norvegjisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Anila Denaj**

#### URDHËR

Nr. 1028, datë 26.11.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;



- c) shpendëve dekorativë;  
 ç) materialit biologjik të shpendëve;  
 d) vezëve të shpendëve;  
 dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;  
 e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht.

Nga shteti i Italisë, sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | *Ndarja administrative e nivelit 3 |
|-----|-----------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| 1.  | Sardegna                          | Cagliari                          | Cagliari*                          |
| 2.  | Veneto                            | Padua                             | Casale Di Scodosia*                |
| 3.  | Veneto                            | Verona                            | Bonavigo*                          |
| 4.  | Emilia-Romagna                    | Bologna                           | Crevalcore*                        |
| 5.  | Emilia-Romagna                    | Ferrara                           | Codigoro*                          |
| 6.  | Emilia-Romagna                    | Ferrara                           | Lagosanto*                         |
| 7.  | Friuli-Venezia Giulia             | Udine                             | San Giorgio Di Nogaro*             |
| 8.  | Lombardia                         | Mantua                            | Canneto sull' Oglio*               |
| 9.  | Veneto                            | Treviso                           | Valdobbiadene*                     |
| 10. | Veneto                            | Treviso                           | Breda Di Piave*                    |
| 11. | Veneto                            | Venezia                           | Mirano*                            |
| 12. | Veneto                            | Venezia                           | Pianiga*                           |

Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 989, datë 20.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
Anila Denaj

## URDHËR

Nr. 1029, datë 26.11.2024

### PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, e tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;  
 b) zogjve 24-orësh;  
 c) shpendëve dekorativë;  
 ç) materialit biologjik të shpendëve;  
 d) vezëve të shpendëve;  
 dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;  
 e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | Ndarja administrative e nivelit 3 |
|-----|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| 1.  | Małopolskie                       | Gorlice                           | Bobowa*                           |
| 2.  | Mazowieckie                       | Siedlce                           | Paprotnia*                        |
| 3.  | Łódzkie                           | Skiermiewice                      | Maków*                            |
| 4.  | Łódzkie                           | Łęczyca                           | Łęczyca (rural)*                  |
| 5.  | Łódzkie                           | Łask                              | Sędziejowice*                     |
| 6.  | Zachodniopomorskie                | Police                            | Kolbaskowo*                       |
| 7.  | Warmińsko-Mazurskie               | Nowe Miasto                       | Kurzętnik*                        |
| 8.  | Zachodniopomorskie                | Gryfino                           | Gryfino*                          |
| 9.  | Wielkopolskie                     | Kalisz                            | Lisków*                           |
| 10. | Dolnośląskie                      | Trzebnica                         | Wisznia Mała*                     |
| 11. | Wielkopolskie                     | Środa Wielkopolska                | Środa Wielkopolska*               |
| 12. | Wielkopolskie                     | Ostrów Wielkopolski               | Raszków*                          |
| 13. | Wielkopolskie                     | Poznań                            | Kleszczewo*                       |
| 14. | Wielkopolskie                     | Września                          | Miłosław*                         |
| 15. | Lubelskie                         | Lubartów                          | Uścimów*                          |
| 16. | Dolnośląskie                      | Wołów                             | Wińsko*                           |
| 17. | Lubuskie                          | Świebodzin                        | Świebodzin*                       |
| 18. | Śląskie                           | Gliwice                           | Toszek*                           |
| 19. | Dolnośląskie                      | Góra                              | Niechłów*                         |

Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.



3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 991, datë 20.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Anila Denaj**

**URDHËR**  
**Nr. 1030, datë 26.11.2024**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË  
SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, e tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

Nga shteti i Italisë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

| Ndarja administrative e nivelit të parë | Ndarja administrative e nivelit të dytë* | Ndarja administrative e nivelit të tretë |
|-----------------------------------------|------------------------------------------|------------------------------------------|
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Aosta*                                   |
| <b>Valle d'Aosta</b>                    | <b>Aosta</b>                             | <b>Antey-Saint-Andrè*</b>                |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Arvier*                                  |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Arnad*                                   |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Aymavilles*                              |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Bard*                                    |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Brissogne*                               |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Charvensod*                              |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Chambave*                                |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Champorcher*                             |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Chamois*                                 |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Chatillon*                               |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Challand-Saint-Anselme*                  |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Challand-Saint-Victor*                   |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Cogne*                                   |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Courmayeur*                              |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Donnas*                                  |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Fénis*                                   |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Fontainemore*                            |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Gignod*                                  |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Gressan*                                 |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Gressoney-Saint-Jean*                    |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Hône*                                    |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Perloz*                                  |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Pont-Saint-Martin*                       |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Pontey*                                  |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Pollein*                                 |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Roisan*                                  |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Rhêmes-Saint-Georges*                    |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Nus*                                     |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Montjovet*                               |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Morgex*                                  |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Issime*                                  |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Jovençon*                                |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Lillianes*                               |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Saint-Christophe*                        |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Saint-Denis*                             |
| <b>Valle d'Aosta</b>                    | <b>Aosta</b>                             | <b>Saint-Nicolas*</b>                    |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Quart*                                   |
| <b>Valle d'Aosta</b>                    | <b>Aosta</b>                             | <b>Valpelline*</b>                       |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Verrayes*                                |
| Valle d'Aosta                           | Aosta                                    | Verrès*                                  |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:



i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

d) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose me nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikës 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 996, datë 20.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të



gjalla të llojit ruminantë të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
Anila Denaj

URDHËR  
Nr. 1031, datë 26.11.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE  
ME PATOGJENITET TË LARTË TË  
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E REPUBLIKËS SË ÇEKISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Çekisë, sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | Ndarja Administrative e Nivelit 3 |
|-----|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| 1   | Středočeský                       | Příbram*                          |                                   |
| 2   | Plzeňský                          | Klatovy*                          |                                   |
| 3   | Jihočeský                         | Strakonice*                       |                                   |
| 4   | Plzeňský                          | Plzeň – jih*                      |                                   |
| 5   | Jihomoravský                      | Hodonín*                          |                                   |
| 6   | Jihomoravský                      | Břeclav*                          |                                   |
| 7   | Jihomoravský                      | Bno-Venkov*                       |                                   |
| 8   | Liberecký                         | Česká Lípa*                       |                                   |

Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 904, datë 4.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Çekisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
Anila Denaj

URDHËR  
Nr. 1032, datë 26.11.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE  
TË DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN  
E GREQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, neni 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve



të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-s dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

| Ndarja administrative e nivelit të parë            | Ndarja administrative e nivelit të dytë* | Ndarja administrative e nivelit të tretë |
|----------------------------------------------------|------------------------------------------|------------------------------------------|
| Aegean                                             | North Aegean                             | Lesbos*                                  |
| Thessaly and Central Greece                        | Central Greece                           | Lokroi*                                  |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Orestiada*                               |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Alexandroupoli*                          |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Soufli*                                  |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Pangaio*                                 |
| Macedonia and Thrace                               | Central Macedonia                        | Emmanouil Pappas*                        |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Maroneia-Sapes*                          |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Didymoteicho*                            |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Arriana*                                 |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Nestos*                                  |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Iasmos*                                  |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Komotini*                                |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Abdera*                                  |
| Peloponez, Greqia Perëndimore dhe Ishujt Jon       | Peloponez                                | Sikyona*                                 |
| Thessaly and Central Greece                        | Thessaly                                 | Rigas Feraios*                           |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Topeiros*                                |
| Macedonia and Thrace                               | Central Macedonia                        | Volvi*                                   |
| Thessaly and Central Greece                        | Central Greece                           | Dorida*                                  |
| Thessaly and Central Greece                        | Central Greece                           | Karystos*                                |
| Thessaly and Central Greece                        | Thessaly                                 | Mouzaki*                                 |
| Thessaly and Central Greece                        | Thessaly                                 | Volos*                                   |
| Thessaly and Central Greece                        | Thessaly                                 | Tempi*                                   |
| Thessaly and Central Greece                        | Thessaly                                 | Notios Pilios*                           |
| Macedonia and Thrace                               | East Macedonia and Thrace                | Kavala*                                  |
| Thessaly and Central Greece                        | Thessaly                                 | Tyrnavos*                                |
| Thessaly and Central Greece                        | Thessaly                                 | Almyros*                                 |
| Peloponnese, Western Greece and the Ionian Islands | West Greece                              | Missolonghi*                             |
| Macedonia and Thrace                               | Central Macedonia                        | Sithonia*                                |
| Thessaly and Central Greece                        | Central Greece                           | Kymi-Aliveri*                            |
| Aegean                                             | North Aegean                             | Lemnos*                                  |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Greqisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1 Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditët e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

d) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

e) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2 Për spermën e cjepëve dhe deshëve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virus i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe



shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).

2.3 Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Urdhri nr. 987, datë 20.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Anila Denaj**

**URDHËR**  
**Nr. 2176, datë 26.11.2024**

### **PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të gremës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, germa “c”, e pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

### **URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave znj. Kozeta Qehajaj, drejtore e Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve për sa vijon:

- për të trajtuar kërkesat për kopje dokumentacioni të dosjeve të punonjësve të ASHK-së dhe nënshkrimin e kthim-përgjigjeve të këtyre kërkesave;

- për të trajtuar dhe nënshkruar vërtetimet e punës për punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve, nëse e gjykon të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës, sipas këtij urdhri, nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1, të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve dhe drejtori i tyre znj. Kozeta Qehajaj, dhe Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
**Lorena Goxhobelli**



**VENDIM**  
**Nr. 43, datë 8.11.2024**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË**  
**RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME**  
**VLORË SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-në nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

**KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,**

në mbledhjen e datës 8.11.2024, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a.’”,

**KONSTATON SE:**

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a., me shkresën nr. 2817 prot., datë 3.9.2024; me shkresën nr. 2901 prot., datë 11.9.2024, plotësimet, me lëndë “Kërkesë për pajisje me licensë”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për herë të parë.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për herë të parë të Shoqërisë Rajonale UK Vlorë sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit

të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. (NUIS: M37202202E) është themeluar më datë 20.9.2023, me aksionarë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, bashkitë: Vlorë me 41.35%, Himarë me 4.6%, Selenicë me 3.05%.

b) Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a. deklaron se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 309,732 banorë të bashkive Vlorë, Himarë, Selenicë;

c) Drejtues teknik i shoqërisë z. Kendi Manaj është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me Master profesional në Hidroteknikë, në vitin 2018 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Vlorë sh.a. të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licensës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Vlorë sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

**VENDOSI:**

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. me (NUIS M37202202E), në kategoritë:



a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor – Sokol Kananaj;

b) Drejtues teknik – Kendi Manaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. janë bashkitë Vlorë, Himarë, Selenicë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr. 245, datë 2.6.2022, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a.” dhe vendimi i KKRR-së nr. 271, datë 9.7.2021, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Selenicë sh.a.”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Evis Shurdha

## VENDIM

Nr. 46, datë 2.12.2024

### **PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e

tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (vendim i KKRR-së nr. 539),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

Në mbledhjen e datës 2.12.2024, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

KONSTATON SE:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a., me shkresën nr. 1869 prot., datë 28.6.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”, ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifar për shërbimet ujësjellës-kanalizime, sipas tabelës nr. 1 të mëposhtme:

**Tabela 1. Tarifat aktuale dhe të propozuara nga Shoqëria Rajonale UK Shkodër për vitet 2025–2027**

| Kategoria e konsumatorëve    |                       |                          | A. Shërbimi i FU   |                      | B. Shërbimi i KUN-së |                      | D. Tarifë fikse shërbimi |                      |
|------------------------------|-----------------------|--------------------------|--------------------|----------------------|----------------------|----------------------|--------------------------|----------------------|
|                              |                       |                          | Tarifat aktuale    | Tarifat e propozuara | Tarifat aktuale      | Tarifat e Propozuara | Tarifat aktuale          | Tarifat e propozuara |
|                              |                       |                          |                    | Viti 2025–2027       |                      | Viti 2025–2027       |                          | Viti 2025–2027       |
|                              |                       |                          | Lek/m <sup>3</sup> | Lek/m <sup>3</sup>   | Lek/m <sup>3</sup>   | Lek/m <sup>3</sup>   | Lek/m <sup>3</sup>       | Lek/m <sup>3</sup>   |
| Shoqëria Rajonale UK Shkodër | Njësia Shkodër        | 1. Konsumatorë familjarë | 40                 | 70                   | 15                   | 40                   | 100                      | 200                  |
|                              |                       | 2. Konsumatorë publik    | 110                | 140                  | 20                   | 50                   | 100                      | 300                  |
|                              |                       | 3. Konsumatorë privat    | 110                | 140                  | 20                   | 50                   | 100                      | 300                  |
|                              | Njësia Malësi e Madhe | 1. Konsumatorë familjarë | 50                 | 60                   | 12                   | 20                   | 167                      | 200                  |
|                              |                       | 2. Konsumatorë publik    | 120                | 120                  | 15                   | 40                   | 167                      | 300                  |
|                              |                       | 3. Konsumatorë privat    | 120                | 120                  | 15                   | 40                   | 167                      | 300                  |
|                              | Njësia Vau i Dejës    | 1. Konsumatorë familjarë | 42                 | 60                   | 7                    | 20                   | 83                       | 200                  |
|                              |                       | 2. Konsumatorë publik    | 120                | 120                  | 20                   | 40                   | 167                      | 300                  |
|                              |                       | 3. Konsumatorë privat    | 120                | 120                  | 20                   | 40                   | 167                      | 300                  |
|                              | * Njësia Fushë-Arrëz  | 1. Konsumatorë familjarë | 20                 | 60                   | 7.5                  | 20                   |                          | 200                  |
|                              |                       | 2. Konsumatorë publik    | 80                 | 120                  | 10                   | 40                   |                          | 300                  |
|                              |                       | 3. Konsumatorë privat    | 80                 | 120                  | 10                   | 40                   |                          | 300                  |
|                              | Njësia Pukë           | 1. Konsumatorë familjarë | 35                 | 60                   | 8                    | 20                   | 100                      | 200                  |
|                              |                       | 2. Konsumatorë publik    | 130                | 130                  | 16                   | 40                   | 100                      | 300                  |
|                              |                       | 3. Konsumatorë privat    | 140                | 140                  | 16                   | 40                   | 100                      | 300                  |

\* Njësia UK Fushë-Arrëz nuk ka tarifa të miratuara nga ERRU-ja, por janë të miratuara me vendim të këshillit bashkiak përkatës.

2. Me vendimin nr. 26, datë 12.9.2024, “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifar të shoqërisë rajonale ujësjellës-kanalizime Shkodër sh.a.”, Komisioni Kombëtar Rregullator vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të SHRUK-së Shkodër.

3. Kërkesa e Shoqërisë Rajonale UK Shkodër sh.a. për vendosjen e nivelit të ri tarifar për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, i ndryshuar.

Shoqëria Rajonale UK Shkodër aplikon tarifat e miratuara nga ERRU-ja për ish-shoqëritë UK ekzistuese, sipas:

- Vendimit të KKRR-së nr. 37, datë 19.12.2011, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.”.

- Vendimit të KKRR-së nr. 10, datë 16.2.2018, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a.” dhe vendimit të KKRR-së nr. 30, datë 20.6.2019, “Për miratimin e tarifave të largimit të ujërave të ndotura për Malësi e Madhe sh.a.”;

- Vendimit të KKRR-së nr. 74, datë 19.10.2018, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për Shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Vau i Dejës sh.a.”.

- Vendimit të KKRR-së nr. 48, datë 30.12.2013, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Pukë sh.a.”.

4. Shoqëria, në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave, sipas argumenteve të mëposhtme:

a) Nevoja për tarifa të miratuara nga ERRU-ja për gjithë zonën e shërbimit me tendencë unifikimin e tyre.

b) Nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi mbi 100% i kostove operacionale.

c) Aplikimi për nivel të ri tarifar, për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe pagës minimale ndër vite.

d) Përmirësim i cilësisë së shërbimeve të ofruara të FU-së dhe KUN-së, si rezultat i investimeve të parashikuara.

e) Tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo të lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

5. Gjatë procesit të analizës teknike-ekonomike, sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave të përcaktuar në vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021, të ndryshuar, ERRU-ja ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit.



6. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Rajonale Shkodër sh.a. e kriterëve të mëposhtme:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, të ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë sa i takon mbrojtjes së konsumatorëve nga çmimet monopol dhe mbrojtjen e interesave të tyre në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, sa i takon moslejimit të abuzimit me pozitën dominuese në treg, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve, pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes dhe të konkurrentëve të tjerë, pengesat në hyrje në tregun përkatës dhe konkurrencën potenciale;

c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

d) Kërkesave të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

e) Orientimin e tarifave drejt mbulimit të kostove operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

f) Tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

7. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU-ja ka vendosur detyra për t’u realizuar nga UK Rajonale Shkodër sh.a:

a) T’i kushtohet vëmendja maksimale instalimit të matësve në prodhim për të gjitha burimet, si dhe atyre familjarë të parashikuar, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrihet objektivi i vendosur nga ERRU-ja për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;

b) Të kryejë vlerësimin e “Ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet me dhe pa ujëmatës;

c) Të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të patur situatë reale mbi UPA dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet

përkatëse gjatë hartimit të bilancit të ujit për vitin 2024 dhe në vazhdim;

d) Të mbajë aktive vazhdimisht task-forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante), si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;

e) Për aplikimin tarifor të rradhës (jo më vonë se qershor 2027), shoqëria duhet të hartojë planin e biznesit 5-vjeçar, sipas formatit të miratuar nga ERRU-ja, duke përdorur si vit bazë të dhënat e çertifikuara të vitit 2026, i cili duhet të shoqërohet me planet përkatëse të veprimit të mbështetura me projekte dhe me burimet e financimit.

f) Të hartojë urgjentisht planin e menaxhimit të aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara për të planifikuar prioritetet e inestimeve në të ardhmen e afërt, në mënyrë që të evitohet vjetërimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme, e cila lidhet ngushtësisht me strategjinë e zvogëlimit të humbjeve nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet.

g) Të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar, në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të paktën për vitin 2026, si një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e radhës.

h) Me mbështetjen e task-forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si, monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa *online* dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë.

i) Treguesi i eficiencës së stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishme të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumente mbështetëse. Për këtë duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri.

j) T’i kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të këtyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi eficiencën e energjisë, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.



8. Në mbledhjen e datës 11.11.2024, Komisioni Kombëtar Rregullator konkludoi mbi projektvendimin për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Referuar analizës tekniko-ekonomike, ERRU-ja e gjen të justifikuar kërkesën e shoqërisë për ndryshimin e nivelit tarifar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria.

9. Me shkresën nr. 317/1 dhe nr. 317/2, datë 11.11.2024, me lëndë “Mbi aplikimin për nivel të ri tarifar të Shoqërisë Rajonale UK Shkodër”, ERRU-ja ka përcjellë për komente projektvendimin e shoqëruar me relacionin përkatës pranë Shoqërisë UK Rajonale Shkodër, AKUK-së, Autoritetit të Konkurrencës dhe bashkive Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë-Arrëz.

10. Shoqëria Rajonale UK Shkodër, me shkresën nr. 3482/1 prot., datë 21.11.2024, me lëndë “Shprehje mendimi në lidhje me projektvendimin e tarifave të reja të shërbimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. ka përcjellë dakordësinë mbi projektvendimin e KKRR-së. Bashkia Fushë-Arrëz, me shkresën nr. 4392 prot., datë 21.11.2024, me lëndë “Mbi propozimin për nivelin e ri të tarifave të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër”, kërkon që rritja e tarifave të jetë në mënyrë graduale dhe e diferencuar nga bashkitë e tjera të Shoqërisë Rajonale UK Shkodër.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e metodologjisë të miratuar me vendim nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi kërkesën e bashkisë Fushë-Arrëz për rishikim dhe diferencim të tarifave me bashkitë e tjera përbërëse të shoqërisë rajonale UK Shkodër, arrin në konkluzionin se sipas analizës së kryer, tarifat janë të diferencuara dhe të bazuara sipas kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballeshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. si më poshtë:

**Tabela 2. Tarifat e miratuara nga ERRU-ja për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër**

| Njësitë               | Kategoritë e klientëve          | Tarifat e vendosura nga ERRU-ja për periudhën 2025–2027 |
|-----------------------|---------------------------------|---------------------------------------------------------|
| Njësia Shkodër        | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b>                                |
|                       | 1. Klientë familjarë            | 55                                                      |
|                       | 2. Klientë publik               | 110                                                     |
|                       | 3. Klientë privat               | 110                                                     |
|                       | <b>B. Shërbimi i KUN-së</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b>                                |
|                       | 1. Klientë familjarë            | 30                                                      |
|                       | 2. Klientë publik               | 40                                                      |
|                       | 3. Klientë privat               | 40                                                      |
|                       | <b>C. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>                                  |
|                       | 1. Klientë familjarë            | 200                                                     |
|                       | 2. Klientë publik               | 300                                                     |
|                       | 3. Klientë privat               | 300                                                     |
| Njësia Malësi e Madhe | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b>                                |
|                       | 1. Klientë familjarë            | 55                                                      |
|                       | 2. Klientë publik               | 120                                                     |
|                       | 3. Klientë privat               | 120                                                     |
|                       | <b>B. Shërbimi i KUN-së</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b>                                |
|                       | 1. Klientë familjarë            | 20                                                      |
|                       | 2. Klientë publik               | 30                                                      |
|                       | 3. Klientë privat               | 30                                                      |



|                    |                                 |                          |
|--------------------|---------------------------------|--------------------------|
|                    | <b>C. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>   |
|                    | 1. Klientë familjarë            | 200                      |
|                    | 2. Klientë publik               | 300                      |
|                    | 3. Klientë privat               | 300                      |
| Njësia Vau i Dejës | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|                    | 1. Klientë familjarë            | 55                       |
|                    | 2. Klientë publik               | 120                      |
|                    | 3. Klientë privat               | 120                      |
|                    | <b>B. Shërbimi i KUN-së</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|                    | 1. Klientë familjarë            | 20                       |
|                    | 2. Klientë publik               | 30                       |
|                    | 3. Klientë privat               | 30                       |
|                    | <b>C. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>   |
|                    | 1. Klientë familjarë            | 200                      |
|                    | 2. Klientë publik               | 300                      |
|                    | 3. Klientë privat               | 300                      |
| Njësia Pukë        | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|                    | 1. Klientë familjarë            | 40                       |
|                    | 2. Klientë publik               | 130                      |
|                    | 3. Klientë privat               | 140                      |
|                    | <b>B. Shërbimi i KUN-së</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|                    | 1. Klientë familjarë            | 20                       |
|                    | 2. Klientë publik               | 20                       |
|                    | 3. Klientë privat               | 20                       |
|                    | <b>C. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>   |
|                    | 1. Klientë familjarë            | 200                      |
|                    | 2. Klientë publik               | 300                      |
|                    | 3. Klientë privat               | 300                      |
| Njësia Fushë-Arrëz | <b>A. Shërbimi i FU</b>         | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|                    | 1. Klientë familjarë            | 40                       |
|                    | 2. Klientë publik               | 80                       |
|                    | 3. Klientë privat               | 80                       |
|                    | <b>B. Shërbimi i KUN-së</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|                    | 1. Klientë familjarë            | 20                       |
|                    | 2. Klientë publik               | 20                       |
|                    | 3. Klientë privat               | 20                       |
|                    | <b>C. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>   |
|                    | 1. Klientë familjarë            | 200                      |
|                    | 2. Klientë publik               | 300                      |
|                    | 3. Klientë privat               | 300                      |

2. Objektivat e treguesve të performancës në fund të vitit 2026 të vendosura nga ERRU-ja janë:

**Tabela 3. Objektivat e Treguesve të Performancës (TKP)**

| TKP                | Nr. | Emri i TKP-ve                  | Njësia TKP | Objektivat sipas ERRU-së në fund të vitit 2026 |
|--------------------|-----|--------------------------------|------------|------------------------------------------------|
| Mbulimi me shërbim | 1.1 | Mbulimi me shërbimin e FU-së   | %          | 57                                             |
|                    | 1.2 | Mbulimi me shërbimin me KUN-në | %          | 33.5                                           |
|                    | 1.3 | Mbulimi me ITUN-në             | %          | 8                                              |
| TKP teknike        | 2.1 | Uji pa të ardhura              | %          | 59                                             |
|                    | 3   | Niveli i matjes                | %          | 90                                             |



|                        |     |                                             |                     |       |
|------------------------|-----|---------------------------------------------|---------------------|-------|
|                        | 4   | Vazhdimësia e furnizimit me ujë             | orë/ditë            | 22.3  |
|                        | 5.1 | Efikasiteti i energjisë për ujin            | kwh/m <sup>3</sup>  | 0.75  |
|                        | 6   | Eficienca e stafit                          | nr./nr./1000 banorë | 1.38  |
| Shërbimi ndaj klientit | 7.1 | Ankesat e klientëve                         | %                   | 10    |
|                        | 7.2 | Ankesat e klientëve që kanë marrë përgjigje | %                   | 100   |
|                        | 7.3 | Ankesat e klientëve që kanë marrë zgjidhje  | %                   | 96.6  |
| TKP financiare         | 8.1 | Norma korrente e arkëtimit                  | %                   | 80    |
|                        | 8.2 | Norma e përgjithshme e arkëtimit            | %                   | 100.1 |
|                        | 9.2 | Mbulimi i kostove O&M                       | %                   | 92.3  |

3. Pagesa rregullatore vjetore për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. do të jetë 0.77% e të ardhurave të parashikuara nga aktiviteti sipas analizës tekniko-ekonomike.

4. UK Rajonale Shkodër sh.a. detyrohet të nënshkruajë kontratën “Për aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU-ja dhe shlyerjen e pagesës rregullatore”, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

5. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2025 dhe është i vlefshëm deri në 31.12.2027.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARE

Evis Shurdha

## VENDIM

Nr. 47, datë 2.12.2024

### PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME GJIROKASTËR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe

largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (vendimi i KKRR-së nr. 539),

## KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

Në mbledhjen e datës 2.12.2024, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

## KONSTATON SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a., me shkresën nr. 1864 prot., datë 27.6.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifar për shërbimet ujësjellës-kanalizime sipas tabelës nr. 1 të mëposhtme:

Tabela 1. Tarifat aktuale dhe të propozuara nga Shoqëria Rajonale UK Gjirokastrë për vitet 2025–2027

| Kategoria e konsumatorëve |                        |                          | A. Shërbimi i FU-së |                      | B. Shërbimi i KUN-it |                      | D. Tarifë fikse shërbimi |                      |
|---------------------------|------------------------|--------------------------|---------------------|----------------------|----------------------|----------------------|--------------------------|----------------------|
|                           |                        |                          | Tarifat aktuale     | Tarifat e propozuara | Tarifat aktuale      | Tarifat e propozuara | Tarifat aktuale          | Tarifat e propozuara |
|                           |                        |                          |                     | Viti 2025–2027       |                      | Viti 2025–2027       |                          | Viti 2025–2027       |
| A. Shërbimi i FU-së       |                        |                          | Lek/m <sup>3</sup>  | Lek/m <sup>3</sup>   | Lek/m <sup>3</sup>   | Lek/m <sup>3</sup>   | Lek/m <sup>3</sup>       | Lek/m <sup>3</sup>   |
| Njësia Gjirokastrë        | Gjirokastrë            | 1. Konsumatorë familjarë | 46                  | 50/55/60             | 11                   | 15                   | 100                      | 200                  |
|                           |                        | 2. Konsumatorë publikë   | 133                 | 133                  | 18                   | 20                   | 100                      | 400                  |
|                           |                        | 3. Konsumatorë privatë   | 138                 | 138                  | 18                   | 20                   | 100                      | 400                  |
|                           | Njësitë Administrative | 1. Konsumatorë familjarë | 25                  | 30                   |                      |                      | 80                       | 200                  |



|                  |                 |                          |                         |                     |            |    |     |     |
|------------------|-----------------|--------------------------|-------------------------|---------------------|------------|----|-----|-----|
|                  |                 | 2. Konsumatorë publikë   | 60                      | 110                 |            |    | 80  | 400 |
|                  |                 | 3. Konsumatorë privatë   | 60                      | 120                 |            |    | 80  | 400 |
| Njësia Tepelenë  | Njësia Tepelenë | 1. Konsumatorë familjarë | 33                      | 50                  | 12         | 15 | 90  | 200 |
|                  |                 | 2. Konsumatorë publikë   | 100                     | 110                 | 20         | 20 | 400 | 400 |
|                  |                 | 3. Konsumatorë privatë   | 120                     | 120                 | 20         | 20 | 250 | 400 |
| Njësia Përmet    | Njësia Përmet   | 1. Konsumatorë familjarë | 40/<br>33.33*<br>/16.7* | 50/<br>55<br>/60/30 | 6/5/2.5*   | 15 | 100 | 200 |
|                  |                 | 2. Konsumatorë publikë   | 110/<br>41.67*          | 133                 | 16.5/6.25* | 20 | 100 | 400 |
|                  |                 | 3. Konsumatorë privatë   | 120/<br>41.67*          | 138                 | 18/6.25*   | 20 | 200 | 400 |
| Njësia Memaliaj  | Njësia Memaliaj | 1. Konsumatorë familjarë | 33                      | 50                  | 12         | 15 | 90  | 200 |
|                  |                 | 2. Konsumatorë publikë   | 100                     | 110                 | 20         | 20 | 400 | 400 |
|                  |                 | 3. Konsumatorë privatë   | 120                     | 120                 | 20         | 20 | 250 | 400 |
| Njësia Këlcyre*  | Njësia Këlcyre  | 1. Konsumatorë familjarë | 37                      | 50                  |            | 15 | 100 | 200 |
|                  |                 | 2. Konsumatorë publikë   | 80                      | 110                 |            | 20 | 100 | 400 |
|                  |                 | 3. Konsumatorë privatë   | 100                     | 120                 |            | 20 | 100 | 400 |
| Njësia Libohovë* | Njësia Libohovë | 1. Konsumatorë familjarë | 26.3/36.2               | 30                  |            | 15 | 250 | 200 |
|                  |                 | 2. Konsumatorë publikë   | 70                      | 110                 |            | 20 |     | 400 |
|                  |                 | 3. Konsumatorë privatë   | 90                      | 120                 |            | 20 |     | 400 |
| Njësia Dropull*  | Njësia Dropull  | 1. Konsumatorë familjarë | 23                      | 30                  |            |    |     | 200 |
|                  |                 | 2. Konsumatorë publikë   | 56                      | 110                 |            |    |     | 400 |
|                  |                 | 3. Konsumatorë privatë   | 26                      | 120                 |            |    |     | 400 |

\* Tarifa të pamiratuara nga ERRU-ja, por të vendosura sipas vendimeve të këshillave bashkiakë përkatës

2. Me vendimin nr. 20, datë 9.7.2024, “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifar të shoqërisë rajonale ujësjellës-kanalizime Gjirokastër sh.a.”, Komisioni Kombëtar Rregullator vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të SHRUK-së Gjirokastër.

3. Kërkesa e shoqërisë rajonale UK Gjirokastër sh.a. për vendosjen e nivelit të ri tarifar për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, i ndryshuar.

Shoqëria Rajonale UK Gjirokastër aplikon tarifat e miratuara nga ERRU-ja për ish-shoqëritë UK ekzistuese, sipas:

- vendimit të KKRR-së nr. 7, datë 8.2.2019, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë

dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës-kanalizime Gjirokastër sh.a.;

- vendimit të KKRR-së nr. 42, datë 30.7.2010, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.UK Tepelenë”;

- vendimit të KKRR-së nr. 23, datë 30.4.2013, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të kanalizimeve për sh.a.U Tepelenë”;

- vendimit të KKRR-së nr. 47, datë 30.12.2013, Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Tepelenë”.

- vendimit të KKRR-së nr. 34, datë 11.12.2012, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. U Përmet.

4. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:



a) nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi mbi 100% i kostove operacionale;

b) aplikimi për nivel të ri tarifor për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe pagës minimale ndër vite;

c) përmirësim i cilësisë së shërbimeve të ofruara të FU-së dhe KUN-it si rezultat i investimeve të parashikuara;

d) tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

5. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave të përcaktuar në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, i ndryshuar, ERRU-ja ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit.

6. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Rajonale Gjirokastrë sh.a. e kriterëve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, i ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë sa i takon mbrojtjes së konsumatorëve nga çmimet monopol dhe mbrojtjen e interesave të tyre në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, sa i takon mos lejit të abuzimit me pozitën dominuese në treg, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve, pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes dhe të konkurrentëve të tjerë, pengesat në hyrje në tregun përkatës dhe konkurrencën potenciale;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

d) kërkesave të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”;

e) orientimin e tarifave drejt mbulimit të kostove operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e

operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

7. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU-ja ka vendosur detyra për t’u realizuar nga UK Rajonale Gjirokastrë sh.a.:

a) t’i kushtohet vëmendja maksimale instalimit të matësave në prodhim për të gjithë burimet, si dhe atyre familjarë të parashikuar, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrihet objektivi i vendosur nga ERRU-ja për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;

b) të kryejë vlerësimin e “Ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet me dhe pa ujëmatës;

c) të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përlogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të patur situatë reale mbi UPA dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të ujit për vitin 2024 dhe në vazhdim;

d) të mbajë aktive vazhdimisht Task-Forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;

e) për aplikimin tarifor të rradhës (jo më vonë se në qershor 2027), duke qenë se shoqëria në fund të periudhës rregullatore 2025–2027 do të arrijë të mbulojë mbi 100% kostot O&M, në këtë aplikim të pritshëm shoqëria do të aplikojë sipas metodës “Çmim tavan” të metodologjisë së tarifave, i cili kërkon që të jetë detyruesisht i shoqëruar me Planin e Biznesit 5-vjeçar i aprovuar paraprakisht nga ERRU-ja. Për këtë qëllim shoqëria duhet të ketë parasysh që brenda vitit 2027 të ketë përditësuar Planin e Biznesit 5-vjeçar duke përdorur si vit bazë të dhënat e çertifikuara të vitit 2026, i cili duhet të shoqërohet me planet përkatëse të veprimit të mbështetura me projekte dhe me burimet e financimit;

f) të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara për të planifikuar prioritetet e investimeve në të ardhmen e afërt në mënyrë që të evitohet vjetërimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme, e cila lidhet ngushtësisht me strategjinë e zvogëlimit të humbjeve nga rrjedhjet dhe eliminimin



e rrezikut të cënimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet;

g) të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të paktën për vitin 2026, si një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e radhës;

h) me mbështetjen e Task-Forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim, si: monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa *on-line* dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë;

i) treguesi i efikasitetit të stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumenta mbështetëse. Për këtë duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri;

j) t'i kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të këtyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi efikasitetin e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.

8. Në mbledhjen e datës 23.10.2024, Komisioni Kombëtar Rregullator konkludoi mbi projektvendimin për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Referuar analizës tekniko-ekonomike, ERRU-ja e gjen të justifikuar kërkesën e shoqërisë për ndryshimin e nivelit tarifor, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria.

9. Me shkresën nr. 407 dhe me shkresën nr. 416, datë 24.10.2024, me lëndë “Mbi aplikimin për nivel të ri tarifor të shoqërisë rajonale UK Gjirokastrë”, ERRU-ja ka përcjellë për komente projektvendimin e shoqëruar me relacionin përkatës pranë shoqërisë UK Rajonale Gjirokastrë, AKUK, Autoritetit të Konkurrencës dhe bashkive Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj, Dropull dhe Libohovë.

10. Shoqëria Rajonale UK Gjirokastrë, me shkresën nr. 3034/1 prot., datë 31.10.2024, me lëndë “Shprehje mendimi në lidhje me projektvendimin e

Komisionit Kombëtar Rregullator mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale ujësjellës-kanalizime Gjirokastrë sh.a. dhe AKUK me shkresën nr. 3197/1 prot., datë 8.11.2024”, me lëndë “Kthim përgjigje”, kanë përcjellë dakordësinë e tyre mbi projektvendimin e KKRR-së. Bashkia Përmet me shkresën nr. 2834/1 me lëndë “Kthim përgjigje” kërkon rishikimin e tarifave volumetrike për shërbimin e FU-së dhe KUN-it për klientët familjarë si dhe diferencim të tarifave të klientëve familjar të FU-së dhe KUN-it ndërmjet zonës urbane dhe zonës rurale (njësitë administrative) për bashkinë Përmet. Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 705/3 prot., datë 11.11.2024, ka dërguar rekomandimet përkatëse mbi projektvendimin.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, i ndryshuar, dhe mori në konsideratë kërkesën e Bashkisë Përmet, për diferencimin e tarifave të klientëve familjar të zonës urbane dhe rurale për shërbimin e furnizimit me ujë, arrin në konkluzionin se sipas analizës së kryer, tarifat janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenevet 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a., si më poshtë:



Tabela 2. Tarifat e miratuara nga ERRU-ja për shogërinë rajonale UK Gjirokastrër

| Njësitë |                     | Kategoria e klientëve           | Tarifat e vendosura nga ERRU-ja për periudhën 2025–2027 |
|---------|---------------------|---------------------------------|---------------------------------------------------------|
| ZONA A  | Njësia Gjirokastrër | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b>                                |
|         |                     | 1. Klientë familjarë            | 50                                                      |
|         |                     | 2. Klientë publikë              | 133                                                     |
|         |                     | 3. Klientë privatë              | 138                                                     |
|         |                     | <b>B. Shërbimi i KUN-it</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b>                                |
|         |                     | 1. Klientë familjarë            | 15                                                      |
|         |                     | 2. Klientë publikë              | 20                                                      |
|         |                     | 3. Klientë privatë              | 20                                                      |
|         |                     | <b>D. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>                                  |
|         |                     | 1. Klientë familjarë            | 200                                                     |
|         |                     | 2. Klientë publikë              | 300                                                     |
|         |                     | 3. Klientë privatë              | 300                                                     |
|         | Njësia Përmet       | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b>                                |
|         |                     | 1. Klientë familjarë            | 50                                                      |
|         |                     | 2. Klientë publikë              | 110                                                     |
|         |                     | 3. Klientë privatë              | 120                                                     |
|         |                     | <b>B. Shërbimi i KUN-it</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b>                                |
|         |                     | 1. Klientë familjarë            | 15                                                      |
|         |                     | 2. Klientë publikë              | 20                                                      |
|         |                     | 3. Klientë privatë              | 20                                                      |
|         |                     | <b>D. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>                                  |
|         |                     | 1. Klientë familjarë            | 200                                                     |
|         |                     | 2. Klientë publikë              | 300                                                     |
|         |                     | 3. Klientë privatë              | 300                                                     |
| ZONA B  | Tepelenë Njësia     | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b>                                |
|         |                     | 1. Klientë familjarë            | 50                                                      |
|         |                     | 2. Klientë publikë              | 100                                                     |
|         |                     | 3. Klientë privatë              | 120                                                     |

|  |                 |                                 |                          |
|--|-----------------|---------------------------------|--------------------------|
|  |                 | <b>B. Shërbimi i KUN-it</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|  |                 | 1. Klientë familjarë            | 15                       |
|  |                 | 2. Klientë publikë              | 20                       |
|  |                 | 3. Klientë privatë              | 20                       |
|  |                 | <b>D. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>   |
|  |                 | 1. Klientë familjarë            | 200                      |
|  |                 | 2. Klientë publikë              | 400                      |
|  |                 | 3. Klientë privatë              | 300                      |
|  | Njësia Memaliaj | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|  |                 | 1. Klientë familjarë            | 50                       |
|  |                 | 2. Klientë publikë              | 100                      |
|  |                 | 3. Klientë privatë              | 120                      |
|  |                 | <b>B. Shërbimi i KUN-it</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|  |                 | 1. Klientë familjarë            | 15                       |
|  |                 | 2. Klientë publikë              | 20                       |
|  |                 | 3. Klientë privatë              | 20                       |
|  |                 | <b>D. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>   |
|  |                 | 1. Klientë familjarë            | 200                      |
|  |                 | 2. Klientë publikë              | 400                      |
|  |                 | 3. Klientë privatë              | 300                      |
|  | Njësia Këlcyre  | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|  |                 | 1. Klientë familjarë            | 50                       |
|  |                 | 2. Klientë publikë              | 100                      |
|  |                 | 3. Klientë privatë              | 100                      |
|  |                 | <b>B. Shërbimi i KUN-it</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|  |                 | 1. Klientë familjarë            | 15                       |
|  |                 | 2. Klientë publikë              | 20                       |
|  |                 | 3. Klientë privatë              | 20                       |
|  |                 | <b>D. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>   |
|  |                 | 1. Klientë familjarë            | 200                      |



|        |                                                |                                 |                          |
|--------|------------------------------------------------|---------------------------------|--------------------------|
| ZONA C | Njësia Libohovë                                | 2. Klientë publikë              | 300                      |
|        |                                                | 3. Klientë privatë              | 300                      |
|        |                                                | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|        |                                                | 1. Klientë familjarë            | 30                       |
|        |                                                | 2. Klientë publikë              | 70                       |
|        |                                                | 3. Klientë privatë              | 90                       |
|        |                                                | <b>B. Shërbimi i KUN-it</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|        |                                                | 1. Klientë familjarë            | 15                       |
|        |                                                | 2. Klientë publikë              | 20                       |
|        |                                                | 3. Klientë privatë              | 20                       |
|        |                                                | <b>D. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/lidhje</b>   |
|        |                                                | 1. Klientë familjarë            | 200                      |
|        |                                                | 2. Klientë publikë              | 300                      |
|        |                                                | 3. Klientë privatë              | 300                      |
|        | Njësia Dropull                                 | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|        |                                                | 1. Klientë familjarë            | 30                       |
|        |                                                | 2. Klientë publikë              | 60                       |
|        |                                                | 3. Klientë privatë              | 60                       |
|        |                                                | <b>B. Shërbimi i KUN-it</b>     | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|        |                                                | 1. Klientë familjarë            | -                        |
|        |                                                | 2. Klientë publikë              | -                        |
|        |                                                | 3. Klientë privatë              | -                        |
|        |                                                | <b>D. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/ lidhje</b>  |
|        |                                                | 1. Klientë familjarë            | 200                      |
|        |                                                | 2. Klientë publikë              | 300                      |
|        |                                                | 3. Klientë privatë              | 300                      |
|        | Njësitë Administrative-<br>Gjirokastrë, Përmet | <b>A. Shërbimi i FU-së</b>      | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|        |                                                | 1. Klientë familjarë            | 30                       |
|        |                                                | 2. Klientë publikë              | 60                       |
|        |                                                | 3. Klientë privatë              | 60                       |
|        |                                                | <b>B. Shërbimi i KUN-it*</b>    | <b>Lek/m<sup>3</sup></b> |
|        |                                                | 1. Klientë familjarë            | 15                       |
|        |                                                | 2. Klientë publikë              | 20                       |
|        |                                                | 3. Klientë privatë              | 20                       |
|        |                                                | <b>D. Tarifë fikse shërbimi</b> | <b>Lek/muaj/ lidhje</b>  |
|        |                                                | 1. Klientë familjarë            | 200                      |
|        |                                                | 2. Klientë publikë              | 300                      |
|        |                                                | 3. Klientë privatë              | 300                      |

\* Tarifat për shërbimin e kanalizimeve gjatë periudhës 2025–2027 do të aplikohen vetëm për njësitë administrative të Bashkisë Përmet.

2. Objektivat e treguesve të performancës në fund të vitit 2026 të vendosura nga ERRU-ja, janë:

Tabela 3. Objektivat e treguesve të performancës (TKPs)

| TKP                    | Nr. | Emri i TKP-ve                               | Njësia TKP         | Objektivat e vendosur nga ERRU-ja në fund të vitit 2026 |
|------------------------|-----|---------------------------------------------|--------------------|---------------------------------------------------------|
| Mbulimi me shërbim     | 1.1 | Mbulimi me shërbimin e FU-së                | %                  | 93.91                                                   |
|                        | 1.2 | Mbulimi me shërbimin me KUN-in              | %                  | 29.37                                                   |
| TKP teknike            | 2.1 | Uji pa të ardhura                           | %                  | 37                                                      |
|                        | 3   | Niveli i matjes                             | %                  | 90                                                      |
|                        | 4   | Vazhdimësia e furnizimit me ujë             | orë/ditë           | 22                                                      |
|                        | 5.1 | Efikasiteti i energjisë për ujin            | kWh/m <sup>3</sup> | 0.24                                                    |
|                        | 6   | Eficienca e stafit                          | nr/nr/1000 banorë  | 2.16                                                    |
|                        |     |                                             |                    |                                                         |
| Shërbimi ndaj klientit | 7.1 | Ankesat e klientëve                         | %                  | 2.25                                                    |
|                        | 7.2 | Ankesat e klientëve që kanë marrë përgjigje | %                  | 100                                                     |
|                        | 7.3 | Ankesat e klientëve që kanë marrë zgjidhje  | %                  | 4.42                                                    |
| TKP financiare         | 8.1 | Norma korrente e arkëtimit                  | %                  | 80                                                      |



|     |                                  |   |     |
|-----|----------------------------------|---|-----|
| 8.2 | Norma e përgjithshme e arkëtimit | % | 105 |
| 9.2 | Mbulimi i kostove O&M            | % | 102 |

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a. do të jetë 0.77% e të ardhurave të parashikuara nga aktiviteti sipas analizës tekniko-ekonomike.

4. UK Rajonale Gjirokastrë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kontratën “Për aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU-ja dhe shlyerjen e pagesës rregullatore” brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

5. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2025 dhe është i vlefshëm deri më 31.12.2027.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARE  
Evis Shurdha

**KËRKESË**  
Nr. 1168/9, datë 2.12.2024

### **PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtim muri rrethues për godinën e re të SPAK-ut’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ose Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 650,698.80 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIM MURI RRETHUES PËR GODINËN E RE TË SPAK-ut”

| NR. | PRONARI                |        |         | TË DHËNA HIPOTEKARE |               |                |                  |                   |             |               |        |      | TRUALL          |                   |              | NDËRTESEË       |                   |              | VLERA TOTALE (lekë) | SHËNIME<br>(kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)                                                                                                          |
|-----|------------------------|--------|---------|---------------------|---------------|----------------|------------------|-------------------|-------------|---------------|--------|------|-----------------|-------------------|--------------|-----------------|-------------------|--------------|---------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     | Emri                   | Atësia | Mbiemri | Fshati ose qyteti   | Z. kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja totale | Truall (m²) | Ndërtesë (m²) | Volumi | Faqe | Sipërfaqja (m²) | Çmimi (lekë / m²) | Vlera (lekë) | Sipërfaqja (m²) | Çmimi (lekë / m²) | Vlera (lekë) |                     |                                                                                                                                                                    |
|     | A                      | B      | C       | C                   | Ç             | D              | E                | F                 | H           | I             | J      | K    | O               | P                 | Q            | R               | S                 | T            | Y                   | Z                                                                                                                                                                  |
| 1   | ATEA                   | FEJZI  | MALAJ   | TIRANË              | 8330          | 8/436          | TRUALL           | 111               | 111         | 0             | 36     | 142  | 6.80            | 34,068.00         | 231,662.40   | 0               | 0                 | 0            | 231,662.40          | Shënim. Seksioni D, “Urdhër/ vendim për vendosje sekuestro konservative, me nr. regjistrimi 20116, datë 28.8.2022, afat 99 vjet. Zyra e Përbarimit Privat “Astrea” |
| 2   | REZARTA                | AZMI   | TELA    | TIRANË              | 8330          | 8/469          | TRUALL           | 151               | 151         | 0             | 49     | 246  | 12.30           | 34,068.00         | 419,036.40   | 0               | 0                 | 0            | 419,036.40          |                                                                                                                                                                    |
|     | SHUMA TOTALE PARAPRAKE |        |         |                     |               |                |                  |                   |             |               |        |      |                 |                   | 650,698.80   |                 |                   |              | 650,698.80          |                                                                                                                                                                    |







Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë

